




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT PËR VITIN 2021

Prishtinë, maj 2022

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Mitrovicës së Jugut për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Mitrovicës së Jugut (KMI), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Mitrovicës së Jugut, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

Baza për opinion të kualifikuar është ndërtuar duke u bazuar në gjetjet në vijim:

- B1 Pasuritë e blera gjatë vitit 2021 në vlerë 1,450,990€, parcelat e tokës dhe objekte në pronësi të komunës nuk janë evidentuar në regjistra.
- A1 Keqklasifikimi i shpenzimeve nëpër kategori ekonomike në vlerë prej 582,955€, të realizuara nga Thesari përmes procedurave përbarimore/të gjykatave.
- B2 Në regjistrin e pasurive të komunës ende figurojnë si investime në vijim pasuritë në vlerë prej 3,313,193€, të cilat është dashur të regjistrohen si pasuri dhe të zhvlerësohen.

Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Mitrovicës së Jugut kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A2 Komuna kishte lidhur kontratë me operatorin ekonomik me vlerë të parashikuar të kontratës në vend se të lidhë me çmime për njësi.
- A3 Komuna kishte angazhuar 62 punonjës në sektorin e arsimit pa procedura të rekrutimit.
- A4 Komuna kishte subvencionuar fermerët me makina bujqësore në vlerë 31,377€ në kundërshtim me kriteret e thirrjes publike.
- A5 Komuna kishte subvencionuar dy OJQ në vlerë totale 20,000€ në kundërshtim me rregulloren Nr. 04/2017 për financimin publik të OJQ-ve.
- A6 Komuna kishte lidhur kontratë me çmimet e peshuara me operatorin ekonomik, ndërsa ishte dashur të lidhë kontratë përmes çmimeve për njësi sipas llojeve.
- C1 Komuna gjatë vitit 2021 kishte kryer pagesa në vlerë prej 5,598,507€ apo 1,552 raste të pagesave të cilat e kanë tejkaluar afatin ligjor si dhe kanë shkaktuar pagesa shtesë për procedura përmbartimore.
- B3 Komuna kishte nënshkruar kontratë me vlerë e cila i tejkalon parashikimet buxhetore për 427,864€.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Mitrovicës së Jugut është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Mitrovicës së Jugut në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Mitrovicës së Jugut me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Mitrovicës së Jugut.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlydhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, ne kemi vërejtur fusha ku nevojiten përmirësime të mundshme, rreth menaxhimit financiar dhe kontrollit. Dobësi evidente janë vërejtur në fusha të rëndësishme financiare si: të hyrat, mos respektimi i procedurave të prokurimit, hyrja në obligime pa zotim të mjaftueshëm të mjeteve, të arkëtueshmet, mos prezantimi i saktë i detyrimeve kontingjente në PFV, keqklasifikimi i shpenzimeve si dhe mos regjistrimi i pasurisë jo financiare, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

PFV-të e komunës të përgatitura me datë 31.01.2022 për vitin e përfunduar me 31.12.2021, nuk ishin plotësisht në pajtim me Rregullën Financiare nr. 01/2017. Ato ishin jo të plota dhe të pasakta, prandaj gjatë procesit të auditimit kemi sugjeruar menxhmentin e komunës që PFV-të të korrigojnë. Më tutje, pasqyrat janë korrigjuar dhe dorëzuar në ZKA dhe çështjet e ngritura nga auditimi janë korrigjuar, përveç çështjes së shpalosjes së plotë të pasurive, dhe keq klasifikimi i shpenzimeve që është trajtuar tek kapitulli Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit. Ky raport ka rezultuar me 17 rekomandime, prej tyre dhjetë (10) janë rekomandime të reja, gjashtë (6) të përsëritura dhe një (1) pjesërisht i përsëritur.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Keqklasifikimi i shpenzimeve të ekzekutuara nga Thesari

Gjetja

Sipas nenit 18 pikës 3 të Rregullës financiare nr. 01/2013, shpenzimet duhet të regjistrohen në kode adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, neni 11 i UA 19/2009 për planin kontabël kërkon nga ZKA dhe ZKF që të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.

Gjatë vitit 2021, përmes procedurave gjyqësore dhe të përmbarimit janë ekzekutuar pagesa në vlerë totale prej 4,341,331€, nga kategori të ndryshme ekonomike (për paga e mëditje 1,613,866€, për mallra dhe shërbime 1,095,377€, shpenzime komunale 176,462€, subvencione dhe transfere 98,526€ dhe për Investime kapitale 1,357,100€). Nga këto pagesa kemi vërejtur se ka keqklasifikim të shpenzimeve në vlerë totale prej 582,955€ si:

- Për Paga dhe Mëditje janë paguar nga kategoritë e gabuara ekonomike shuma prej 222,215€, dhe atë: nga Investimet kapitale 100,338€, nga Mallrat dhe Shërbimet 117,462€, dhe nga Subvencionet dhe Transferet shuma prej 4,415€.
- Për Investime Kapitale janë paguar nga kategoritë e gabuara

ekonomike shuma prej 277,137€, dhe atë nga Mallrat dhe Shërbimet 78,924€, nga Shpenzimet Komunale 117,924€ dhe nga Subvencionet dhe Transferet shuma prej 80,289€.

- Për Mallra dhe Shërbime janë paguar nga kategoritë e gabuara ekonomike shuma prej 83,602€, dhe atë: nga Investimet Kapitale shuma prej 59,808€, nga Shpenzimet Komunale 20,664€ dhe nga Subvencionet dhe Transferet shuma prej 3,130€.

Sa i përket pagave dhe Mëditjeve kjo ka ndodhur pjesërisht për shkak të ndikimit të Kontratës kolektive (pasi e njëjta nuk është marrë parasysh nga Ministria e Financave gjatë planifikimit të buxhetit ndër vite) dhe pjesa tjetër është pasojë e mosplanifikimit të mirë të shpenzimeve dhe mos pagesës me kohë të shpenzimeve të krijuara nga Komuna. Edhe pse në raportin e vitit të kaluar, keqklasifikimi i shpenzimeve ka qenë i theksuar si çështje, megjithatë, komuna nuk ka arritur të përmirësojë këtë dukuri.

- Ndikimi** Keqklasifikimi i shpenzimeve ndikon në mbivlerësim/nënvlerësim të shpenzimeve në kategoritë përkatëse të shpenzimeve dhe në paraqitje jo të saktë të shpenzimeve në PFV.
- Rekomandimi A1** Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprimet e nevojshme që pagesat të realizohen sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të shpenzimeve në PFV, në përputhje me planin kontabël të Thesarit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Menaxhim jo i duhur i regjistrave të pasurive

- Gjetja** Rregullorja MF Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare të Organizatave Buxhetore, neni 6, citon që: çdo organizatë buxhetore duhet të krijoj dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që ka në menaxhimin e saj. Më tej, potencohet se regjistri i pasurive duhet të përfshijë pasuritë kapitale mbi 1,000€ të cilat duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuritë jo kapitale nën 1,000€ dhe stoqet në sistemin E-pasuria.

Regjistri i pasurive mbi 1,000 euro ishte i nënvlerësuar për vlera materiale për shkak se pagesat për Investime Kapitale të cilat janë realizuar gjatë vitit 2021 nga Thesari përmes procedurave përbarimore në vlerë prej 1,450,990€, nuk janë evidentuar në regjistra. Përveç kësaj as parcelat e tokës në pronësi të komunës dhe shumë objekte të Komunës nuk janë evidentuar në regjistrin e pasurive (si shembull vlen të përmenden objekti i vet Komunës, palestra sportive Minatori, dy stadiumet e qytetit, Qendra Multifunkionale në vlerë mbi 20 milion €, dhe disa objekte tjera).

Sistemi e-pasuria nuk është funksional dhe nuk përdoret fare nga Komuna. Në vend të kësaj pasuritë nën 1,000€ janë evidentuar në excell dhe për to nuk është kalkuluar zhvlerësimi. Rrjedhimisht informatat e shpalosura në PFV në lidhje me pasuritë janë materialisht të pasakta.

Shkaku për menaxhimin jo të duhur të regjistrave të pasurive janë veprimet e pamjaftueshme të komunës në drejtim të menaxhimit të duhur të pasurive, përfshirë mungesën e evidentimit dhe vlerësimin të pasurive dhe azhurnimit të regjistrave.

Ndikimi Mos regjistrimi i të gjitha pasurive të Komunës në regjistrat e pasurive, ndikon në mungesë të informatave të menaxhmentit në lidhje me pasuritë që posedon komuna, dhe paraqet mos përbushje të kërkesave ligjore në lidhje me evidentimin e pasurive. Po ashtu kjo ndikon në shpalosje të pasaktë të informatave për pasuritë në PFV.

Rekomandimi B1 Kryetari, duhet të sigurojë se janë ndërmarrë masat e nevojshme për të siguruar se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar, vlerësuar dhe regjistruar në regjistrat përkatës, për të siguruar që prezantimi i informatave për pasuritë në PFV të jetë i saktë dhe i plotë. Po ashtu sistemi e-pasuria duhet të funksionalizohet dhe të regjistrohen pasuritë nën 1,000€.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Mos-mbyllja e kategorisë së investimeve në vijim pas pranimit të pasurisë

Gjetja Neni 12 paragrafi 2 dhe 3 të Rreg. nr. 02/2013 - Për menaxhimin e pasurisë jo financiare në Organizatat Buxhetore, përcakton se: “Deri në momentin e pranimit të pasurisë jo financiare organizatat buxhetore financuese do të regjistrojnë transaksion në kategorinë e investimeve në vijim. Në momentin kur pasuria jo financiare i ka kaluar të gjitha rregullat dhe procedurat e pranimit nga ana e organizatës buxhetore, e cila e fiton të drejtën e pronësisë mbi pasurinë përkatëse, atëherë kategoria e investimeve në vijim mbyllet edhe në regjistrat e organizatës buxhetore pranuese dhe organizatës buxhetore bashkë financuese.”

Nga analizimi i regjistrat të pasurive kemi vërejtur se pasuritë e blera/përfituara nga komuna para dhe gjatë vitit 2019 në vlerë prej 3,313,193€, janë të regjistruara si investime në vijim dhe për to nuk është kalkuluar zhvlerësimi, edhe pse shumica nga këto investime janë të përfunduara dhe do të duhej të regjistrohen si pasuri në përdorim si dhe të zhvlerësohen.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos koordinimit ndërmjet zyrtares së pasurisë dhe njërive tjera për tu informuar lidhur me projektet e përfunduara.

Ndikimi Mungesa e informatave të plota dhe të sakta lidhur me pasurinë në dispozicion të komunës ndikon në menaxhim jo të mirë të pasurive dhe prezantim jo të drejtë në PVF.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të siguroj se zyrtarët përgjegjës posedojnë informatat në lidhje me regjistrin e pasurisë, në mënyrë që për projektet e përfunduara të finalizoj procesin e regjistrimit të pasurisë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A2 - Mangësi në vlerën e parashikuar të kontratës

Gjetja Sipas LPP-së, neni 17, Llogaritja e Vlerës së Parashikuar të Kontratës për Shërbime, vlera e parashikuar e kontratës së propozuar për shërbime është e barabartë me pagesën e përgjithshme dhe shumat e kompensueshme që do të paguhen nga autoriteti kontraktues sipas kontratës, përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, duke pasur parasysh dispozitat e këtij neni.

Te kontrata kornizë “Shërbimi i transportit të nxënësve të shkollave fillore ” destinacioni Koprivë - Shipol dhe anasjelltas dhe Vërnice - Pirqë dhe anasjelltas, vlera e parashikuar e kontratës ishte prej 144,000€, kontrata ishte nënshkruar me operatorin ekonomik fitues të tenderit por vlera e parashikuar ishte vendosur gabimisht, pasi nuk është e përafërt me sasinë e shërbimeve që do të ofrohen. Vlera e parashikuar e kontratës do të duhej përlllogaritur me çmimin për njësi në lotin e IV-të që është 81.60€ *185 ditë mësimdhënie gjatë vitit * 3 vite që në total jep vlerën e llogaritur që është dashur të lidhet kontrata për 45,288€, si rezultat i kësaj vlera e gabuar është 98,712€.

Ky gabim ka ndodhur për shkak të neglizhencës së zyrtarëve përgjegjës për përlllogaritjen e përafërt të vlerës së parashikuar të kontratës.

Ndikimi Gabimet e lëshuara gjatë lidhjes së kontratës mund të keqkuptohen nga pala tjetër dhe të krijohet pakënaqësi e cila mund të shpije në padi gjyqësore.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë që gabimi i tillë të korrigohet duke bërë përpjekje për zgjidhje të marrëveshjes dhe të kërkojë që shuma e kontraktuar të korrigohet dhe nënshkruhet nga të dyja palët.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Angazhimi i punonjësve të arsimit pa procedura të rekrutimit dhe mos raportim i obligimeve ndaj tyre, në PFV

Gjetja Sipas nenit 8 të ligjit të punës Nr.03/L-212, Punëdhënësi në sektorin publik, është i obliguar që të shpall konkurs publik sa herë që pranon një punëmarrës dhe themelon një marrëdhënie të punës.

Komuna, respektivisht Departamenti Komunal i Arsimit (DKA) gjatë vitit 2021 kishte angazhuar 62 punonjës me kontrata të përkohshme pasi që konkurset për pranimin e tyre kishin dështuar. Kemi testuar (5) kontrata të tilla, të cilat ishin nënshkruar kryesisht në muajin tetor dhe nëntor 2021. Këta punonjës ashtu siç është sqaruar edhe në PFV kanë mbetur jashtë listës së pagave dhe nuk janë kompensuar për punën e kryer. Po ashtu, obligimet financiare ndaj tyre nuk janë raportuar në PFV si obligime të pa paguara.

Pranimi i punëtorëve pa procedura të rregullta ka ndodhur për shkak të dështimit të procedurave të rekrutimit dhe me arsyetimin se vendet e punës duhet të plotësohen në mënyrë që mësimi nëpër shkolla të vazhdojë me

rregull. Derisa mos paraqitja e obligimeve për pagat e punëtorëve ka ndodhur si pasojë e mungesës së informatave nga departamenti i financave.

Ndikimi

Të punësuarit e angazhuar në formë të kontratave të përkohshme pa zhvilluar paraprakisht procedura të rekrutimit siç kërkohet me ligj mund të ndikoj që të përzgjidhen kandidatë që nuk i plotësojnë kriteret e parapara për mësimdhënie dhe njëherit të dëmtohet procesi i transparencës që do të ndikojë në cilësinë jo adekuate në mësimdhënie. Mos raportimi i obligimeve ndikon në cilësinë dhe saktësinë e informatave të shpalosura në PFV.

Rekomandimi A3

Kryetari duhet të sigurojë se pozitat e lira të punës plotësohen nëpërmjet procedurave të rregullta të rekrutimit përmes konkursit publik dhe punonjësit të përfshihen në listën e pagave. Po ashtu në rast se Komunës i mbeten obligime të papaguara ndaj punëtorëve, ato obligime duhet të raportohen në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja A4 - Subvencionimi i fermerëve në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në Thirrjet Publike****Gjetja**

Sipas Thirrjes Publike për subvencionimin e fermerëve me makina bujqësore kërkohej që përfituesit të jenë banorë të Komunës së Mitrovicës; të kenë sipërfaqe të mjaftueshme të tokës; të ketë planifikuar mbjelljen e së paku 2ha e më tepër me kultura lavërtare dhe perimekulturë; të posedojë traktor me fuqi më të madhe se 28kw; përparësi kanë fermerët të cilët nuk kanë përfituar nga Drejtoria e Bujqësisë në dy vitet e fundit; dhe përfituesit duhet të jenë të gatshëm të participojnë me 30%. Derisa Thirrja Publike për subvencionimin e fermerëve për kredi bujqësore përcaktonte se dokumentet e nevojshme për aplikim, midis tjerash janë edhe: lista poseduese e tokës dhe vërtetimi i tatimit në pronë.

Ne testimi i tre aplikuesve fitues për thirrjen publike për subvencionimin e fermerëve me Makina Bujqësore ku totali i subvencionimit sipas kësaj thirrje ishte 31,377€, asnjëri nga këta aplikues nuk kishte ofruar dëshmi për posedim të traktorit siç kërkohej me kriteret. Po ashtu kemi vërejtur se komisioni i vlerësimit në formularin e poentimit ka përdorë kriteret e cilat nuk kanë qenë të përfshira në Thirrjen Publike. Si pasojë, janë fituar pikë dhe janë vlerësuar përfituesit, si: kategoritë e familjeve me jetimë, familjet e dëshmorëve, martirëve, veteranëve; familjet me distancë të largët; familjet me anëtarë të papunë; dhe familjet me numër të fëmijëve të caktuar.

Ndërsa në subvencionimin e fermerëve me Kredi Bujqësore, ku totali i subvencionimit ishte 22,964€, gjatë testimit të aplikacioneve të dy përfituesve, njëri nga aplikuesit nuk kishte përmbushur kriteret për dokumentet e nevojshme, pasi që i mungonte lista poseduese e tokës dhe vërtetimi i tatimit në pronë.

Kjo ka ndodhur si pasojë e mosrespektimit të kriterëve të shpalljes publike nga ana e komisionit vlerësues.

Ndikimi

Subvencionimi i fermerëve duke përdorur kriteret të cilat nuk kanë qenë të shpallura në Thirrje Publike dhe subvencionimi i tyre pa përmbushur kriteret

e shpallura, dëmton transparencën dhe shfaqë dyshime në tërë procesin, pasi që janë eliminuar nga procesi aplikues potencial, derisa janë shpërblyer fermer jo-meritor kundrejt kriterëve të shpallura në Thirrje Publike.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të sigurojë se Thirrjet Publike për subvencionimin të fermerëve të përmbajnë kriteret të qarta të cilat plotësohen me dokumentet e kërkuara, dhe se Komisionet e Vlerësimit të vlerësojnë aplikacionet në përputhje të plotë me kriteret e shpallura në Thirrje Publike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A5 - Subvencionimi i OJQ-ve në kundërshtim me Rregulloren e Financimit Publik të OJQ-ve

Gjetja

Rregullorja e MF - NR - 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve përcakton kriteret, standardet dhe procedurat themelore për financimin publik të Organizatave Jo-Qeveritare, dispozitat e së cilës zbatohen nga çdo Organizatë Buxhetore, si dhe mënyrën e raportimit nga përfituesit e subvencioneve, që përfshin edhe raporte narrative dhe financiare.

Subvencionet për Klubin e Basketbollit Trepça (5,000€) dhe për Klubin e Zhytësve Trepça (15,000€), janë dhënë nga Komuna përmes Vendimeve të Kuvendit, duke anashkaluar kriteret e Rregullores MF-Nr.4/2017. Rrjedhimisht me këta përfitues nuk janë nënshkruar marrëveshje dhe nuk janë kërkuar raporte kthyese financiare dhe narrative siç kërkohet me rregullore.

Si pasojë e ndryshimeve të menaxhimit në komunë, nuk ka qenë e mundur të identifikohen shkaqet për anashkalim të procedurave.

Ndikimi

Subvencionimi i OJQ-ve duke anashkaluar Rregulloren, përveç që dëmton transparencën dhe besimin në Komunë, shfaqë mëdyshje mbi procesin dhe sigurinë se paratë e dhëna si subvencion do të shpenzohen për qëllime të lejuara, pasi që mungojnë marrëveshjet midis Komunës dhe përfituesit në lidhje me kushtet e shpenzimit të fondeve, dhe mënyrën e raportimit.

Rekomandimi A5 Kryetari duhet që të sigurojë se për të gjitha subvencionimet e OJQ-ve që kualifikohen për t'u trajtuar sipas Rregullores së lartpërmendur të shpallet Thirrje Publike dhe të aplikohen kërkesat që rrjedhin nga kjo Rregullore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A6 - Mangësi në procedurën e prokurimit dhe përcaktimin e çmimit/vlerës së kontratës

Gjetja Sipas pikës 56.15 e RrUOPP-së potencon që kurdo që Autoriteti kontraktues nuk dinë sasi të indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshët në bazë të rëndësisë së secilës "kategori të shërbimeve" ose secilit "artikull" në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Në këto raste në hapje publike të ofertave lexohet çmimi total i poentuar (peshuar) i cili shërben vetëm për qëllim të vlerësimit të ofertave ndërsa kontrata lidhet me çmime për njësi.

Te kontrata "Furnizim me barna dhe material mjekësor si çmim i kontratës për të dy llotet ishin vendosur çmimet e peshuara (për Llot 1 - 2,978€ dhe për Llot 2 -2,452€ duke mos e shpjeguar se këto janë çmimet e peshuara), derisa ofertat financiare sipas çmimeve për njësi ishin: për Llot 1 - 10,575€ dhe për Llot 2 - 3,959€, dhe kontrata është dashur të lidhet sipas këtyre çmimeve.

Kjo ka ndodhur si pasojë e moszbatimit korrekt të kërkesave ligjore të Prokurimit Publik nga ana e zyrtarëve të përfshirë në proces.

Ndikimi Vendosja e çmimeve të peshuar si çmime/vlerë të kontratës mund të qojë në keqkuptime sa i përket vlerës së kontratës.

Rekomandimi A6 Kryetari duhet të sigurojë që gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit dhe përcaktimit të çmimit/vlerës së kontratave, të respektohen në mënyrë rigorozë kërkesat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe rregullat e udhëzimet përcjellëse.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja B3 - Nënshkrimi i kontratës përtej vlerës së parashikuar të buxhetit**

Gjetja Sipas LPP-së Neni 9, pika 3 - Nëse autoriteti kontraktues është organizatë buxhetore dhe prokurimi përkatës do të shkaktojë ngritjen e obligimeve financiare të cilat do të përmbushen nga ndarjet buxhetore që pritet të bëhen në vitet e ardhshme fiskale. ZKF do të siguroj që tabelat e bashkëngjitura të Ligjit për Ndarjet Buxhetore, ofrojnë bazë të arsyeshme për të pritur se në vitet e ardhshme fiskale do t'i ofrohen fonde të mjaftueshme për përmbushjen e obligimeve të tilla.

Për projektin "Furnizim me material ndërtimor" - vlera e parashikuar sipas Ligjit për Ndarjet Buxhetore, për vitin 2021 dhe dy vitet pasuese (2022 dhe 2023) ishte 72,000€ ndërsa komuna kishte nënshkruar kontratë tre vjeçare në vlerë 499,864€ apo 427,864€ më e lartë se vlera e parashikuar me Ligjin për ndarjet Buxhetore për vitin 2021.

Kjo ka ndodhur si pasojë e planifikimit jo të mirë të projekteve dhe futja e tyre në ligj të buxhetit pa një analizë paraprake të mirëfilltë.

Ndikimi Hyrja në obligime kontraktuale përtej mundësive buxhetore ndikon në implementimin e projekteve sipas planifikimeve si dhe krijon vështirësi për

komunën në përmbushjen e obligimeve të krijuara.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të siguroj se do të aplikohen në mënyrë strikte kërkesat ligjore dhe nënshkrimi i kontratave të bëhet në përputhje me buxhetin e planifikuar/aprovuar, në mënyrë që implementimi i projekteve të realizohet në kohë, dhe mos të krijohen vështirësi financiare për komunën.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C1 - Vonesa në pagesën e faturave dhe shpenzimet shtesë të procedurave përmbartimore

Gjetja

Sipas nenit 39.1 të ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP), Çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës. Ndërsa, sipas nenit 40, fatura mund të ekzekutohet direkt nga Thesari pas marrjes së urdhrin të prerë nga gjykata/përmbartuesi.

Nga analiza e data bazës së furnitorëve kemi vërejtur se komuna gjatë vitit 2021 kishte kryer pagesa në vlerë prej 5,598,507€ apo 1,552 raste të pagesave të cilat e kanë tejkaluar afatin ligjor për pagesë, vonesat variojnë nga 1 deri në 823 ditë. Këto pagesa kryesisht kanë të bëjnë me Investime Kapitale, Mallra dhe Shërbime, dhe Paga e Mëditje.

Si pasojë, shumica nga këto pagesa janë bërë nga thesari përmes procedurave të përmbartimit.

Nga 102 raste të pagesave të verifikuara me vlerë të përbashkët prej 1,361,344€, borxhi ishte 1,217,050€, ndërsa shpenzimet shtesë për procedurat përmbartimore/gjyqësore 144,294€.

Duke qenë se, përmes urdhrave përmbartimor dhe vendimeve të gjykatave, gjatë vitit 2021 janë kryer pagesa nga Thesari në vlerë totale prej 4,341,331€, shpenzimet përmbartimore janë më të larta. Komuna nuk ka informata se sa ishte borxhi dhe sa mjete janë paguar për shpenzime të përmbartimit/gjykatës.

Kjo ka ndodhur si pasojë e planifikimit jo të duhur, hyrja në obligime pa pasur mjaftueshëm mjete si dhe neglizhenca e zyrtarëve përgjegjës për kompletimin e lëndëve për pagesë.

Ndikimi

Mos pagesa e faturave dhe obligimeve me kohë e ekspozon Komunën ndaj padive nga operatorët ekonomik, duke shkaktuar shpenzime shtesë gjyqësore/ përmbartimore dhe të kamatave. Kjo poashtu e prish planin e shpenzimeve dhe pamundëson arritjen e objektivave të përcaktuara.

Rekomandimi C1 Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha faturat dhe obligimet të paguhen brenda afateve kohore ligjore me qëllim që mos të dëmtohet buxheti i komunës me kosto shtesë të përmbartimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna e Mitrovicës së Jugut në 2021 ishin në vlerë 3,271,712€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Po ashtu kishte një kthim të mjeteve nga të hyrat e vitit të kaluar në vlerë prej 61,784€ të cilat në tabelë janë prezantuar si të hyra tjera. Në totalin e të hyrave të realizuara janë përfshirë edhe të hyrat indirekte nga gjobat në trafik në vlerë prej 252,749€, gjobat e gjykatave 67,493€ dhe të hyrat nga Agjencia e Pyjeve 71€.

Çështja A7 - Përfitimi i paligjshëm i tatimpaguesve i Zbritjes për Vendbanim Parësor

Gjetja Ligji Nr. 06/L-005 Për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, Neni 11, Zbritja për Vendbanimin Parësor, midis tjerash përcakton se personi fizik i cili ka në pronësi apo posedim dy (2) ose më shumë njësi rezidenciale të objekteve, mundet vetëm njëherë prej këtyre objekteve ta deklarojë si vendbanim të tij parësor, me ç'rast i lejohet zbritja prej pesëmbëdhjetë mijë eurove (15,000€) nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit.

Gjatë analizës së bazës së dhënave të tatimit në pronë, janë identifikuar disa raste të tatimpaguesve të cilët kanë të evidentuara si vendbanim të tyre parësor dy e më shumë objekte banimi, (një tatimpagues kishte të regjistruara 24 objekte si vendbanime parësore). Kjo është konstatuar përmes numrit personal të tatimpaguesve. Për më tepër, situata është më serioze sepse më shumë se 4,000 tatimpagues të prezantuar në këtë Bazë të dhënave, nuk kanë të prezantuar numrat personal, të cilët në bazë të emrave, mbiemrave dhe emrit të prindit, mund të jenë përfitues të disahershëm nga zbritja e lejuar ligjore.

Kjo ka ndodhur si pasojë e mos verifikimit të pronave në fjalë dhe mos azhurnimit të shënimeve në sistemin e tatimit në pronë.

Ndikimi Përfitimi i disahershëm i zbritjes për vendbanim parësor përveç që është i paligjshëm dhe i padrejtë, mund të nxisë edhe tatimpaguesit tjerë që të veprojnë njëjtë, meqenëse Komuna nuk ka ndërmarrë ndonjë masë monitoruese apo ndëshkuese për ta parandaluar këtë fenomen.

Rekomandimi A7 Kryetari duhet të ndërmerr veprime të menjëhershme të identifikimit të të gjithë përfituesve të disahershëm të zbritjes së vendbanimit parësor dhe t'i ndërmarrin masat ligjore, si dhe të plotësojnë bazën e të dhënave me të gjithë numrat personal të tatimpaguesve, në mënyrë që të verifikohen të gjitha rastet.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A8 - Mos-inspektimi i 20% të objekteve komunale

Gjetja Ligji nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, Neni 15, përcakton se Komuna çdo vit inspekton të paktën njëzet përqind (20%) të të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës dhe për të ndihmuar në veprimtaritë inspektuese mund të angazhojë edhe inspektorë privat.

Komuna ka më shumë se 22,000 objekte të regjistruara në regjistrin e objekteve dhe zyrtarët kanë filluar procesin e inspektimit të tyre por në vitin 2021 kishte arritur të bëjë inspektimin (verifikimin) e vetëm 700 objekteve apo rreth 4%.

Sipas zyrtareve të Tatimit në Pronë kjo ka ndodhur për shkak se numri i punëtorëve në këtë Njësi nuk është i mjaftueshëm dhe për këtë nuk ia kanë arritur ta përmbushin këtë kërkesë ligjore.

Ndikimi

Mos arritja e inspektimit të 20% të objekteve mund të rezultojë në ngarkesë të tepërt apo të pakët tatimore për tatimpaguesit, që në cilindo rast njëra palë potencialisht është e dëmtuar.

Rekomandimi A8

Kryetari duhet të ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar burime të nevojshme për Departamentin e Tatimit në Pronë, qoftë përbrenda Komunës apo edhe të angazhojë inspektorë privat në pajtim me dispozitën ligjore, në mënyrë që të përmbushen këkesat ligjore të inspektimit të pronave komunale.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 4,685,959€, prej tyre ishin shpenzuar 4,310,034€. Ato kanë të bëjnë me ndërtimin e rrugëve lokale, ndriçim publik, ujësjellës dhe kanalizim, objekte shëndetësore etj.

Çështja A9 - Vonesa në nënshkrimin e kontratave

- Gjetja** Sipas RrUOPP neni 31 pika 3 Validiteti i Tenderit. specifikon se; “Periudha e kërkuar e validitetit do të jetë jo më shumë se që është e nevojshme, dhe do të jetë e mjaftueshme për AK të bëjë vlerësimin e tenderëve të pranuar dhe të bëjë dhënien dhe nënshkrimin e kontratës”. po ashtu neni 21 i RrUOPP, përcakton se te Procedura e Hapur e prokurimit për Kontrata të Mëdha afati për dorëzimin e ofertave është 40 ditë, ndërsa në rastin e afateve kohore të përshpejuara për Kontrata të Mëdha, afati për dorëzimin e ofertave duhet të jetë 15 ditë. Ndërsa, Paragrafi 47.6 përcakton se Autoriteti kontraktues mund të përdorë procedurë të përshpejtuar, kur shfaqen rrethanat e parashikuara në Nenin 46 të Ligjit të Prokurimit, të cilat duhet të arsyetohen me shkrim.
- Te kontrata “Zgjerimi dhe mirëmbajtja e rrjetit të ndriçimit publik” me vlerë të parashikuar prej 480,000€, periudha e caktuar e validitetit të sigurisë së tenderit ishte 90 ditë nga dita e dorëzimit të ofertës (që ishte me datë 15.07.2021). Afati i sigurisë së tenderit i fituesit të këtij tenderi kishte skaduar 8 ditë para nënshkrimit të kontratës. Po ashtu, njoftimi për vendimin e Autoritetit Kontraktues ishte bërë me datën 30.04.2021, derisa AK kishte nënshkruar kontratën me OE me datë 23.07.2021 me rreth 3 muaj vonesë nga publikimi i rezultatit të aktivitetit të prokurimit. Për zhvillimin e kësaj procedure të prokurimit ishin përdorur procedura/afate të shkurtuara për shkak të nevojës për sigurimin e shërbimeve të synuara. Vonesa në nënshkrimin e kontratave kishte edhe në katër raste tjera (“Hartimi dhe Mbikëqyrja e Projekteve për Investime Kapitale”, “Ndërtimi dhe Asfaltimi i Rrugëve në Fshatrat Vërrnicë dhe Rrugëve në Fshatin Bare”, ” Punët në Shenjzimin Horizontal dhe Vertikal në Qytet”, dhe ” Furnizim me material ndërtimor për Ndërtim dhe Renovim te Shtëpive”), përkundër faktit se ishin aplikuar afate të përshpejtuar për pranimin e ofertave duke dhënë arsytimin me shkrim për nevojën e përshpejtimit të procedurave. Kjo kishte ndodhur si pasojë e neglizhencës së zyrës së prokurimit.
- Ndikimi** Vonesat në nënshkrimin e kontratave ndikojnë në marrjen me vonesë të shërbimeve dhe punëve dhe në mos realizimin e planit të aktiviteteve dhe realizimin e buxhetit të Komunës. Ndërkohë shkurtimi i afateve kohore për pranimin e ofertave ua pamundëson Operatorëve Ekonomik të interesuar përgatitjen dhe dorëzimin e ofertave të tyre, marrë parasysh qëllimin, kërkesat dhe kompleksitetin e procesit përkatës të prokurimit.
- Rekomandimi A9** Kryetari duhet të sigurojë që Njësia e Prokurimit të bëjë planifikime të duhura dhe me kohë në mënyrë që afatet kohore të përshpejtuar të eliminohen ose të përdorën minimalisht në mënyrë që të mos dëmtohet konkurrenca dhe potencialisht buxheti i Komunës për mallrat/punët/shërbimet e siguruara. Njëkohësisht duhet të siguroj që pas përfundimit të vlerësimit të ofertave të mos vonohet nënshkrimi i kontratave në mënyrë që të fitohet kohë për realizimin e projekteve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Të arkëtueshmet

Komuna e Mitrovicës së Jugut në PFV e vitit 2021 ka shpalosur Llogari të Arkëtueshme (LLA) në vlerë prej 12,750,721€. Kjo vlerë përbehet nga të arkëtueshmet e tatimit në pronë, tarifat e pa arkëtuara të tarifave komunale, të arkëtueshmet për mbledhjen e mbeturinave, të arkëtueshmet nga qiraja etj. Në krahasim me vitin paraprak LLA janë rritur për 1,247,289€.

Çështja B4 - Sfidat në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme

Gjetja Sipas nenit 26 të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme 06-L 005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove dhe neni 27 Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori. Arkëtimi i të hyrave tjera duhet të bëhet sipas afateve kohore të përcaktuara në faturë apo rregullore për secilin lloj të të hyrave.

Komuna nuk po arrin të krijojë mekanizma për zvogëlimin e LLA. Krahasuar me vitin paraprak 2020, LLA kanë arritur vlerën totale në 12,750,721, ku nga viti paraprak janë rritur për rreth 11%. Sfida kryesore mbetet inkasimi i tatimit në pronë që në vitin 2021 ka arritur vlerën prej 7,249,498€, të hyrat nga tarifat komunale në vlerë 1,966,496 € dhe të hyrat nga mbeturinat në vlerë prej 2,086,444€. Në bazë të lëndëve që kanë qenë pjesë e mostrave të auditimit në kategorinë e LLA, në asnjë rast nuk kemi hasur që Komuna në vitin 2021 ka ndërmarrë ndonjë veprim ligjor për mbledhjen e borxhit.

Rritja e LLA ka ardhur për shkak të veprimeve të pamjaftueshme të Komunës në drejtim të inkasimit të borxheve.

Ndikimi Mungesa e veprimeve të mjaftueshme apo mangësitë në procesin për arkëtimin e LLA, mund t'i dekurajojnë tatimpaguesit tjerë që t'i paguajnë obligimet e tyre me kohë. Për më tutje, mos realizimi i të hyrave të planifikuara, rritë rrezikun e dështimit të projekteve të planifikuara nga burimet vetanake. Vjetërsia e të arkëtueshmeve e vështirëson mbledhjen e tyre.

Rekomandimi B4 Kryetari, duhet të sigurojë se ka forcuar kontrollin në menaxhimin e të arkëtueshmeve, rritjen e efikasitetit si dhe forcimin e kontrolleve në menaxhimin dhe arkëtimin e tyre. Në këtë aspekt, të analizohen shkaktarët e rritjes së të arkëtueshmeve në mënyrë që të ndërmerren veprimet ligjore për mbledhjen e tyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B5 - Mungesa e veprimeve ligjore për mbledhjen e të Arkëtueshmeve dhe menaxhim jo adekuat i pronave komunale të dhëna me qira dhe dosjeve të LLA

Gjetja Pjesa e pasme e faturës së taksës komunale për Ushtrim të Veprimtarisë Afariste përcakton që taksa për biznesin llogaritet në baza vjetore bazuar në Rregulloren Komunale për Taksa Tarifa dhe Gjobat dhe pagesa mund të bëhet në 4 këste pa kamatë dhe gjobë, mirëpo pas kalimit të afateve ligjore të parapara për pagesë, Komuna do të aplikojë inkasim të detyrueshëm. Ndërsa kontratat e lidhura për qiradhënie për prona komunale ,specifikojnë se shumat e qirasë paguhen në baza mujore.

Gjatë testimit të 16 mostrave kemi gjetur se taksat e paguara për Ushtrim të Veprimtarisë Afariste kanë mbetur pa u paguar për periudha deri në gjashtë vite. Ndërsa, nga auditimi i 16 mostrave të qiradhënies së pronave komunale, kemi gjetur se qiradhënësit shfrytëzojnë pronat me kontrata të skaduara deri në 10 vite, dhe nuk i kanë përmbushur detyrimet. Në një rast një qiramarrësit i ishte shkëputur një kontratë në vitin 2017 dhe si rezultat i kishte mbetur Komunës borxh 205,500€. Pavarësisht kësaj, Komuna kishte vendosur në vitin 2018 të lidhë një kontratë të re të qiradhënies me të njëjtin shfrytëzues, por për një pronë tjetër me pagesë mujore prej 632€. Edhe për këtë kontratë ky qiramarrës ka mbetur borxh në shumë prej 7,589€. Për më tepër, pothuajse asnjë nga lëndët e testuara nuk përmbajnë komplet faturat e paguara dhe ato të pa paguara nga qiradhënësit, ku faturat lëshohen nga Komuna vetëm me kërkesë të borxhliut. Prandaj nuk mund të konfirmohet se kartelat e borgjeve, dhe shuma e shpalosur e llogarive të arkëtueshme janë të sakta.

Kjo ka ndodhur si pasojë e neglizhencës së stafit dhe mos përcaktimit të saktë të personave/departamenteve përgjegjëse për menaxhimin e kontratave të qirasë.

Ndikimi Mos marrja e masave për mbledhjen e borxhit ndikon në rritjen e të arkëtueshmeve; shpërblimi me kontratë i borxhlinjve të vjetër pa paguar borxhin i nxit borxhlinjtë që ta shtyjnë borxhin apo mos të paguajnë fare, derisa mos kompletimi i dosjeve/kartelave të borxhlinjve nuk japin siguri se borxhi është i saktë. Ndërsa mos lëshimi dhe mos dërgimi i faturës për borxhlinjtë shfaqë pikëpyetjen se a janë të vetëdijshëm borxhlinjtë se janë duke u faturuar, marrë parasysh që disa nuk kanë paguar për gjysmë dekadë.

Rekomandimi B5 Kryetari duhet të adresojë problemet e lartpërmendura duke ndërmarrë masa ligjore ndaj borxhlinjve sipas kushteve të dakorduara, të trajtohen kontratat e skaduara sipas procedurave të parapara, dhe të dërgojnë faturat tek borxhlinjtë si përkujtim apo dhe vërejtje në lidhje me shumën që duhet paguar. Gjithashtu, zyrtarët të ndërmarrin veprime për plotësimin e lëndëve të borxhlinjve, në mënyrë që të ketë dëshmi që ofrojnë siguri se shumat e paraqitura të LLA janë të sakta.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.4 Detyrimet kontingjente

Pasqyra e detyrimeve kontingjente në fund të vitit 2021, ishte 4,537,055€.

Çështja A10 - Prezantimi jo i plotë i detyrimeve kontingjente

- Gjetja** Neni 18 i Raportit Vjetor Financiar për Organizatat Buxhetore parasheh prezantimin e detyrimeve kontingjente dhe shpalosjen në detaje të shënimeve në tabelë.
- Komuna në PFV kishte shpalosur detyrime kontingjente me vlerë prej 4,537,055€ për konteste gjyqësore për kompensime të pronës dhe shërbimeve, Pretendimet e punonjësve të arsimit për kompensimin e shujtave, pagave përcjellëse dhe jubilarë të punonjësve (gjithsej 1269 punonjës që kanë bërë padi), nuk janë shpalosur si detyrime kontingjente në PVF.
- Kjo ka ndodhur për shkak të mos menaxhimit të mirë të informatave rreth detyrimeve kontingjente dhe koordinimit jo adekuat ndërmjet departamentit ligjor dhe departamentit të financave.
- Ndikimi** Mos prezantimi i plotë i detyrimeve kontingjente (pasive gjyqësore) shkakton nënvlerësim të tyre dhe për pasojë mund të ketë planifikimin jo të duhur të buxhetit për mbulimin e detyrimeve në vitet pasuese në rast të humbjes së këtyre kontesteve.
- Rekomandimi A10** Kryetari duhet të sigurojë që informatat rreth detyrimet kontingjente azhurnohen rregullisht dhe të njëjtat prezantohen drejtë në PFV, duke përfshirë vlerësimet financiare për secilën padi.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.5 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me tre anëtarë të stafit-Drejtori i NjAB dhe dy auditor. Komuna po ashtu ka themeluar komitetin e auditimit i cili është funksional. NjAB përveç planit strategjik kishte hartuar Planin Vjetor për vitin 2021 dhe deri në fund të vitit kishte finalizuar gjashtë raporte të Auditimit, aq sa ishin planifikuar. Auditimet kanë mbuluar fushën e prokurimit, dhënien në shfrytëzim të pronave publike, departamentin komunal të arsimit, drejtorinë e shëndetësisë, zyrën e personelit, dhe departamentin për integritet evropian dhe mirëqenie sociale. Auditimi i Drejtorisë së Prokurimit kishte në fokus vitin 2021, dy auditime tjera kanë përfshirë pjesërisht vitin 2021, dy auditime tjera kishin në fokus vetëm vitin 2020, derisa një auditim kishte në fokus vitet 2019-2020.

Çështja B6 - Zbatimi i rekomandimeve të NJAB-së jo në nivelin e kënaqshëm

Gjetja	<p>Sipas udhëzimit administrativ nr. 01/2019 për themelimin dhe funksionimin e komitetit të auditimit për sektorin publik, neni 7, paragrafi 1.7 thekson se Komiteti i auditimit shqyrton raportet përmbledhëse, gjetjet, rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe siguron që ato janë adresuar siç duhet nga udhëheqësi i subjektit të sektorit publik.</p> <p>Nga vlerësimi i zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga NjAB është vërejtur zbatim i ulët i rekomandimeve. Nga 32 rekomandime të dhëna, 10 ishin zbatuar ndërsa 8 ishin në proces dhe 14 rekomandime nuk ishin zbatuar.</p> <p>Shkaku i mos zbatimit të rekomandimeve është mungesa e planeve të veprimit dhe mungesa e një procesi formal të monitorimit të tyre nga menaxhmenti.</p>
Ndikimi	<p>Mos implementimi i rekomandimeve të NjAB-së mund të ndikojë në përsëritjen e gabimeve dhe dobësive të identifikuara nga auditimi i brendshëm.</p>
Rekomandimi B6	<p>Kryetari duhet të siguroj se rekomandimet e dala nga auditimi i brendshëm përcillen me një plan veprimi për implementimin e tyre si dhe një proces formal të monitorimit dhe raportimit nga njësitë përgjegjëse dhe të njëjtat rishikohen në mënyrë periodike për të parë progresin e zbatimit të tyre.</p>

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar informata të përmbledhura për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave të mëposhtme:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁴	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Burimet e fondeve	22,115,361	22,918,889	22,394,096	21,203,738	19,555,066
Grante Qeveritare - Buxheti	19,615,386	19,350,409	19,306,154	18,874,382	16,950,914
Financimi përmes huamarrjes	0	60,970	60,955	115,801	52,878
Të bartura nga viti i kaluar	0	719,087	715,326	441,740	347,061
Të hyrat vetanake	2,499,975	2,335,857	2,248,778	1,316,604	2,116,286
Donacionet vendore	0	89,134	45,555	49,084	16,464
Donacionet e jashtme	0	363,432	17,328	406,127	71,463

Buxheti përfundimtar është më i lartë se buxheti fillestar për 803,528€. Rritja është rezultat i të hyrave të bartura dhe donacioneve derisa nga granti qeveritar kishte zvogëlim të fondeve buxhetore.

Në vitin 2021 Komuna e Mitrovicës së Jugut ka shpenzuar 98% të buxhetit përfundimtar ose 22,394,096€, me një përmirësim për 7% në krahasim me vitin 2020. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	22,115,361	22,918,889	22,394,096	21,203,738	19,555,066
Pagat dhe mëditjet	12,165,605	13,633,717	13,614,018	12,187,045	11,885,268
Mallrat dhe shërbimet	2,668,883	3,149,269	3,047,293	3,338,650	2,072,726
Komunalitë	493,815	477,214	466,332	382,851	482,100
Subvencionet dhe transferet	530,043	972,730	956,418	718,371	531,282
Investimet Kapitale	4,360,511	4,685,959	4,310,034	4,576,821	4,583,690
Rezervat	1,896,504	0	0	0	0

Shpjegimet për ndryshimet dhe realizimin e buxhetit për kategori ekonomike janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,468,112€ si rezultat i të hyrave të bartura, huasë, dhe donacioneve të jashtme. Realizimi i buxhetit në këtë kategori ishte 99,86%.
- Buxheti final për investime kapitale ishte rritur për 325,448€. Kjo rritje ishte rezultat i të hyrave të bartura, huasë dhe donacioneve të jashtme. Buxheti në këtë kategori është shpenzuar rreth 92%. Megjithë nivelin relativisht të lartë të realizimit të kësaj kategori, disa nga projektet e buxhetuara nuk ishin realizuar fare derisa të disa tjera kishte shpenzime përtej planifikimeve fillestare buxhetore.
- Buxheti final për Subvencione dhe transfere ishte rritur për 442,678€ në krahasim me buxhetin fillestar, si rezultat i të hyrave vetanake të bartura dhe granteve të donatorëve. Realizimi në këtë kategori ishte 98% e buxhetit final.
- Buxheti final për mallra dhe shërbime gjithashtu ishte rritur për 480,386€ në krahasim me buxhetin fillestar si rezultat i rishikimit të buxhetit, të hyrave vetanake të bartura dhe donacioneve. Ndërsa ekzekutimi i buxhetit është relativisht i lartë në këtë fushë me rreth 97%.
- Buxheti final për shërbime komunale ishte zvogëluar në krahasim me buxhetin fillestar për 16,601€. Shpenzimi i buxhetit në këtë kategori në fund të vitit kishte arritur nivelin 98%.
- Mjetet e shpenzuara në vitin 2021 për Rimëkëmbjen Ekonomike ishin 451,746€, ato kryesisht ishin ndarë për shtesa në arsim dhe shëndetësi.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2021



Të hyrat e realizuara nga Komuna e Mitrovicës së Jugut në 2021 ishin në vlerë 3,271,712.14€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Po ashtu kishte një kthim të mjeteve nga të hyrat e vitit të kaluar në vlerë prej 61,784 € të cilat në tabelë janë prezantuar si të hyra tjera. Vlen të theksojmë se në raport me vitin e kaluar komuna ka realizuar të hyra më shumë për 935,855€.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Pranimet	2020 Pranimet	2019 Pranimet
Totali i të hyrave	2,499,975	2,335,857	3,271,712	1,766,659	2,304,797
Të hyrat tatimore	977,388	934,702	1,002,543	645,927	775,500
Të hyrat jo tatimore	1,522,587	1,401,155	2,207,385	1,120,732	1,529,297
Të hyrat tjera	0	0	61,784		

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e Komunës së Mitrovicës së Jugut të vitit 2020 ka rezultuar në 13 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatojë rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit për vitin 2021, gjashtë (6) rekomandime janë zbatuar, një (1) rekomandim ishte në proces të zbatimit, gjashtë (6) nuk janë zbatuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari duhet të sigurojë që obligimet të planifikohen/buxhetohen dhe paguhen brenda afateve kohore të parapara ligjore me qëllim që mos të dëmtohet buxheti i komunës me kosto shtesë të përmbarimit.	Në buxhetin e vitit 2022 janë planifikuar mjetet për pagesën e borgjeve dhe urdhërave përmbarimor, derisa pagesa me kohë e faturave të pa paguara të shpalosura në PFV është vështirë e realizueshme për shkak se buxheti është aprovuar në muajin shkurt 2022, prandaj do të ketë vonesa edhe në vitin 2022.	Pjesërisht i zbatuar
2.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari duhet të konsiderojë që me rastin e planifikimit të buxhetit t'i trajtojë obligimet e mbetura me Ministrinë e Financave dhe të vendosë prioritetet buxhetore në kryerjen e tyre.	Komuna në buxhetin e vitit 2022 ka planifikuar buxhet për pagesën e faturave të papaguara dhe urdhërave përmbarimi.	I zbatuar
3.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprimet e duhura ligjore që pronat e shfrytëzuara nga personat privat apo juridik të rikthehen nën kontroll të komunës, ose të bëhet ripërtërija e kontratave në mënyrë që komuna të arkëtojë të hyra nga dhënia në shfrytëzim e pronave.	Nuk kemi pasur raste të tilla në këtë vitë.	I zbatuar
4.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë rritjen e nivelit të mbikëqyrjes dhe menaxhimit të kontratave publike, duke siguruar informacion të saktë dhe të mjaftueshëm rreth zbatimit të kontratave, si dhe për progresin në zbatimin e kontratave të raportohet tek kryetari dhe tek zyra e prokurimit në baza të rregullta kohore një apo tre mujore.	Nuk kemi pasur raste të tilla në këtë vitë.	I zbatuar

5.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të siguroj përmes menaxherit të prokurimit se aplikohen në mënyrë strikte kërkesat ligjore që kanë të bëjnë me sigurinë e ekzekutimit para lidhjes së kontratës, në mënyrë që të sigurohet mbarëvajtja e obligimeve kontraktuale nga ana e operatorëve ekonomik.	Nga mostrat e testuara nuk kemi gjetur raste të tilla këtë vit.	I zbatuar
6.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se do të aplikohen në mënyrë strikte kërkesat ligjore në mënyrë që nënshkrimi i kontratave të bëhet në përputhje me buxhetin e planifikuar dhe aprovuar, në mënyrë që implementimi i projekteve të realizohet në kohë, dhe pa shpenzime shtesë.	Nuk janë marrë masa.	Nuk ka filluar zbatimin
7.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se aplikohen në tërësi të gjitha kushtet e vendosura në kontratë, duke aplikuar edhe deklaratën e nënshkruar nga OE për garancionin e punimeve të ekzekutuara/realizuara.	Nuk kemi vërejtur raste të ngjajshme këtë vit.	I zbatuar
8.	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet të sigurojë nivelin adekuat të përgjegjësisë në zbatimin e afateve kohore të përcaktuara lidhur me njoftimin për nënshkrimin e kontratës sipas kërkesave në Ligjin e Prokurimit Publik.	Në kontratat e testuara këtë viti njoftimet janë bërë sipas afateve ligjore.	I zbatuar
9.	Pasuritë	Kryetari duhet të siguroj se zyrtarët përgjegjës posedojnë informatat në lidhje me regjistrin e pasurisë, në mënyrë që për projektet e përfunduara të finalizoj procesin e regjistrimit të pasurisë.	Nuk janë marrë masa për zbatimin e këtij rekomandimi	Nuk ka filluar zbatimin
10.	Pasuritë	Kryetari, duhet të ndërmerr masa për të siguruar se pasuritë mbi dhe nën 1,000€ janë regjistruar në regjistrat përkatës, për të gjitha pasuritë që ka në posedim në mënyrë që prezantimi i informatave në PFV të jetë i saktë dhe i plotë. Njëherit duhet të siguroj që është vënë në përdorim e-pasuria dhe raporti i inventarizimit merret në konsideratë para përgatitjes së PFV.	Edhe këtë vit është gjendja e njëjtë me regjistrimin dhe evidencat e pasurive.	Nuk ka filluar zbatimin
11.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari, duhet të ndërmerr masa për të siguruar se llogaritë e arkëtueshme janë të evidentuara saktë dhe me kohë, dhe të bëhen prerja në fund të vitit në mënyrë që në kohën e përgatitjes së PVF-ve për vitin 2021 vlera e tyre të shpaloset saktë.	Saktësinë e disa llogarive të arkëtueshme nuk kemi mundur ta verifikojmë në mungesë të dëshmive complete.	Nuk ka filluar zbatimin
12.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari, duhet të sigurojë se ka forcuar kontrollet në menaxhimin e të arkëtueshmeve, rritjen e efikasitetit si dhe forcimin e kontroleve në menaxhimin dhe arkëtimin e tyre. Në këtë aspekt, të analizohen shkaktarët e rritjes së të arkëtueshmeve në mënyrë që të ndërmerren veprimet ligjore për mbledhjen e tyre.	Komuna nuk ka ndërmarrë masa për zvogëlimin e llogarive të arkëtueshme.	Nuk ka filluar zbatimin

13.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari duhet të siguroj se rekomandimet e dala nga auditimi i brendshëm përcillen me një proces formal të monitorimit dhe raportimit nga njësitë përgjegjëse dhe të njëjtat rishikohen në mënyrë periodike për të parë progresin e zbatimit të tyre.	Përkundër që janë dhënë zotime në planin e veprimit, gjendja me zbatimin e rekomandimeve të NjAB-së është e njëjtë.	Nuk ka filluar zbatimi
-----	----------------------	--	---	------------------------

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Zukë Zuka, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Lavdim Maxhuni, Drejtor i Auditimit



Bujar Bajraktari, Udhëheqës i ekipit




Gazmend Namani, Anëtar i ekipit



Edon Kabashi, Anëtar i ekipit



Fatbardha Jashari, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

	
REPUBLIKA E KOSOVËS Republika Kosova - Republic of Kosovo	
	
Komuna e Mitrovicës së Jugut Opština Južna Mitrovica - Municipality of Mitrovica South	
LETËR E KONFIRMIMIT	
Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Draft-Raportin e Auditimit për vitin 2021 dhe për zbatimin e rekomandimeve	
Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit	
Të nderuar, përmes kësaj shkresë, konfirmoj se:	
<ul style="list-style-type: none">• Kam pranuar Draft-Raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Vjetore Financiare të Komunës së Mitrovicës së Jugut për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021 ;• Pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë komente për përmbajtjen e Draft-Raportit të auditimit për PVF të Komunës së Mitrovicës së Jugut për vitin përfunduar më 31 dhjetor 2021.• Ju njoftoj se brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit Final të ZKA, do t'ju dorëzoj një Plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tij.	
z. Bedri Hamza 	
Kryetar i Komunës të Mitrovicës së Jugut	
Data: 28 Prill 2022, Mitrovicë e Jugut	
	

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁵ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁶, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.